



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.



15

Adresa: Rr. "Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455

Nr. 5480

Nr. 2688 Prot.

Tiranë, më 23.08.2023

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit

Për dijëni : Shoqërisë "Integrated Technology Services" Sh.p.k.

Shoqërisë "STAR - 07" Sh.p.k.

Lënda : Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative

Në Tiranë, sot më datë 23.08.2023,

Unë Kozeta Guri, përmbaruese gjyqësore private pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 83, Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit, Vendimit Nr. 360, datë 26.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë,

KONSTATOVA:

Se në datë 03.08.2023 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimi, Vendimi Nr. 360, datë 26.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lëshuar për titullin ekzekutiv, faturat tatimore të shitjes, me palë:

Kreditor : Shoqëria "STAR - 07" Sh.p.k.

Debitor : Shoqëria "Integrated Technology Services" Sh.p.k.

Me Objekt : pagim fature

Me vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, Vendimi Nr. 360, datë 26.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për:

- Faturë tatimore Nr. 33/2022, lëshuar në datën 05.07.2022, për periudhën 01.07.2022 – 31.07.2022, në shumën 999.283 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) Lekë, me TVSH.

Urdhërohet Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor për ekzekutimin e këtij vendimi".

Në zbatim të këtij titulli ekzekutiv, me shkresën Nr. 2618 Prot., datë 03.08.2023 debitorit i është komunikuar lajmërimi për zbatimin e titullit ekzekutiv në mënyrë vullnetare.

Sa më sipër kur debitori nuk ka përmbushur detyrimin, bazuar në nenin 519, 527, 593 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” dhe Udhëzimit “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat”,

URDHËROJ:

- 1- Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aktivet që zotëron pala debitore të rregjistruara pranë jush:
 - Shoqëria “Integrated Technology Services” Sh.p.k., me NIPT L02302032C,
 - për Vendimin për lëshimin e “Urdhërit të Ekzekutimit”, Vendimi Nr. 360, datë 26.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
- 2- Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë veprimet përkatëse duke ndaluar çdo veprim tjetërsimi apo disponimi mbi aktivet e palëve debitore.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbaruese Gjyqësore Private

Kozeta Guri

